



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1892 / Prot.

Tiranë, më 19 / 04 / 2021

URDHËR

Nr. 219, datë 19.04.2021

**PËR KARANTINIMIN E PERSONAVE QË VIJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT DHE GREQIA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 1, gërma c të Ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik si dhe në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 1892 datë 19.04.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Vetëkarantinimin e detyrueshëm, për një periudhë 14-ditore, për të gjithë shtetasit që hyjnë në Republikën e Shqipërisë përmes rrugëve ajrore, tokësore ose detare nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia, nga data 20.04.2021 deri në datën 03.05.2021.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas Aktit Normativ Nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga Covid-19” i ndryshuar.

Ky urdhër lypn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

